



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm, Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës, me datën 30 maj 2018 bënë:

SHPALLJE PUBLIKE

I. Për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, për kryerjen e detyrave të caktuara në fushat e listuara si në shtojcë të kësaj shpalljeje.

II. Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë të kryer së paku një nivel të studimeve pasuniversitare apo studime të tjera ekuivalente me nivelin pasuniversitar;
2. Së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën ku kërkohet angazhimi;
3. Njohuri të mira për sektorin publik;
4. Preferohet përvojë në shërbimet e konsulencës/ekspertizës në fushën përkatëse.

III. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

Letër Motivuese;
Biografi (CV);
Kopjen e letërnjoftimit;
Dëshminë për studimet pasuniversitare apo licencën e punës (për specialistë të mjekësisë);
Kopjet e trajnimeve relevante të kryera (nëse ka);
Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse; dhe
Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.

IV. Përzgjedhja e kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas procedurës së përcaktuar me Udhëzimin e Administrativ Nr. 02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm.

Me kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet sipas pikës II dhe III të kësaj shpalljeje mund të organizohen takime konsultative me qëllim të qartësimit të angazhimit të tyre, lidhur me kushtet dhe për rezultatet e pritura nga angazhimi i tyre.

Angazhimi në cilësinë e ekspertit nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit. Ekspertët e përzgjedhur do të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës për periudhën e caktuar deri në tre (3) vjet me mundësi të vazhdimit edhe për tri vite tjera. Marrëveshja lidhet sipas dispozitave të aplikueshme të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Angazhimi i ekspertëve bëhet në bazë ditore dhe varësisht prej nevojave të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Për punën e kryer bëhet kompensimi në vlerën e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm.

Ekspertët e përzgjedhur bëhen pjesë e listës zyrtare (bazës së të dhënave) dhe ftohen për angazhim ad hoc në baza ditore, varësisht nga nevojat e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ekspertët e angazhuar duhet të respektojnë standardet e zbatueshme të auditimit të njohura ndërkombëtarisht, Kodin e Etikes dhe rregullat tjera të përcaktuara me aktet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

V. Dorëzimi i dokumenteve

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, në adresën: **Prishtinë, rruga Musine Kokalari nr. 87 ose përmes postës elektronike: rekrutimi@oagks.org**

Dokumentacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara, pa dëshmi).

Mundësia për aplikim mbetet e hapur **tetë (8) ditë** kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht deri me datën 07 qershor 2018, në ora 16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore të ZKA-së, në numrin e tel: 038 606004 lok. 1025, çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00.

Shtojcë për profesionet e caktuara për angazhimin e ekspertëve:

1. Ing. i elektros;
2. Ing. i ndërtimtarisë- konstruksione
3. Arkitekt
4. Projektues
5. Ing. i ndërtimtari (ndërtimi i ulët dhe i lartë)
6. Ing. për teknologji të ushqimit
7. Farmacist;
8. Mjek për shëndet publik;
9. Telekomunikacion;
10. Auditim të performancës / Hulumtues;
11. Ekspert për Mirëqenie sociale;
12. Ekspert për Vlerësim të paluajtshmërive;
13. Ekspert për Mbrojtje të konsumatorit;
14. Ekspert për Sigurime Shëndetësore;
15. Ekspert nga fusha e bujqësisë;
16. Ekspert -Specialist për TI dhe Specialist për software.